



# SIKA AT WORK

## KOMPLEKSI MEMORIAL "DËSHMORËT E KOMBIT", VRELLË, ISTOG

RIPARIM DHE MBROJTJE BETONI: Sikadur®, Sika MonoTop®, Sikagard®

SHTRIM DYSHEMEJE: Sikafloor®

BUILDING TRUST



# KOMPLEKSI MEMORIAL "DËSHMORËT E KOMBIT"

Kompleksi Memorial "Dëshmorët e Kombit" në fshatin Vrellë të komunës së Istogut është ndërtuar gjatë fundit të 2017 dhe gjatë 2018. Është një kompleks varrezash të Dëshmorëve, ku përveç memorialit që shërben si qendër përkujtimore për personalitete apo ngjarje të caktuara historike, përfshin edhe objekte tjera të trashëgimisë kulturo-historike siç janë Amfiteatri dhe Kulla Muze të cilat rrethohen nga një mur betonarmeje.

## KËRKESAT E PROJEKTIT

Duke qenë se të gjitha shkallët e Amfiteatrit janë në mjedis të jashtëm dhe në ekspozim të përhershëm ndaj kushteve të ndryshme klimaterike, kontraktori kërkoi që të trajtohen me shtresë mbrojtëse për betonin, e cila ofron qëndrueshmëri ndaj rrezatimit UV dhe njëkohësisht siguron sipërfaqe me rezistencë ndaj rrëshqitjes.

Materiali që do përdorej duhet të ketë rezistencë në tërheqje sipas DIN 53504 dhe DIN 53505 dhe mundësi për të mbyllur plasaritjet.

Gjithashtu, për murin rrethues prej betonarmeje është kërkuar që të lyhet me shtresë mbrojtëse nga ndikimet atmosferike që nuk ndikon në karakteristikat e teksturës së betonit dhe plotëson kërkesat e standardit EN 1504-2 si shtresë mbrojtëse.



## ZGJIDHJA NGA SIKA

Duke analizuar kërkesat e projektit, Sika propozoi zgjidhjen e mëposhtme:

Shkallët e Amfiteatrit dhe ato për ecje të trajtohen me:

1. Prajmerin epoksid me 2 përbërës Sikafloor®-161, të përshtatshëm për lyerjen e nënshtresave prej betoni me absorbueshmëri të ulët, i cili ofron depërtim dhe ngjitje të mirë të veshjeve vijuese.
2. Pas aplikimit të prajmerit mbi këtë sipërfaqe u bë spërkatja me rërë kuarci të granulometrisë 0,3-0,8 mm.
3. Shtresën përfundimtare poliuretani me 2 përbërës për veshjen e strukturës me Sikafloor®-359 N. Kjo shtresë disponon rezistenca të mira kimike dhe mekanike, nuk zverdhet me kalimin e kohës dhe plotëson kërkesën e kontraktorit për rezistencë ndaj rrëshqitjes.

Ndërsa, për murin rrethues prej betonarmeje u kryen punimet e mëposhtme:

- Për trajtimin e të gjitha çarjeve dhe plasaritjeve, fillimisht u përgatit nënshtresa me gërryerje deri në hapje të strukturës. Pluhuri i krijuar u përthith me fshesë industriale që të arrihej një nënshtresë e pastër, e thatë, pa vaj, yndyrna dhe pjesë të lira e të lëvizshme. Plasaritjet mbi ~ 0.35 mm në -20°C u mbyllën me llaçin epoksid Sikadur®-31 CF Normal.
- Riparimi i segregimeve dhe përmirësimi i sipërfaqeve prej betoni u bë me anë të llaçeve riparues Sika MonoTop®-412 N dhe Sika MonoTop®-910 N.

- Në fillim, mbi sipërfaqe u aplikua me furçë Sika MonoTop®-910 N, llaç me 1 përbërës me bazë çimentoje dhe i modifikuar me polimere që përdoret si shtresë lidhëse për ngjitjen, pjesë e sistemit për riparimin e betonit. Veshjet (2 shtresa në total) u realizuan në diferencë kohore min. 24 orë. Pas 1-3 ditësh nga lyerja e dytë, sipërfaqja u lag me ujë deri në ngopje që të mbetet e lagur "mat" (pa ujë të grumbulluar).

- Pas këtij aplikimi, duke ndjekur parimin "shtresa e lagur mbi të lagur", u aplikua një shtresë 6-50 mm llaçi për riparime strukturore betoni Sika MonoTop®-412 N me 1 përbërës dhe i përforcuar me fibra dhe me tkurrje shumë të ulët. Ky llaç plotëson kërkesat e klasës R4 sipas EN 1504-3. U kushtua kujdes i veçantë për shtresat minimale dhe maksimale në një dorë.

- Gjithashtu, duke patur parasysh kërkesën e klientit për mbrojtjen e betonit nga ndikimet agresive atmosferike, të cilat mund të depërtojnë në formën e e kripërave ose gazeve, muri rrethues u lye me Sikagard®-680 S Betoncolor. Ky produkt është veshje me 1 përbërës dhe përmbajtje tretësi, me bazë rrëshirash metakrilatesh që ofron rezistencë ndaj konsumimit nga kushtet e motit, alkaleve dhe vjetërimit. Pas aplikimit, nuk ndryshon pothuajse fare teksturën e sipërfaqes të betonit.







#### SASIA E PRODUKTEVE SIKA

- Sikafloor®-161: 1,200 kg
- Sikafloor®-359 N: 1,200 kg
- Sikadur®-31 CF Normal: 30 kg
- Rërë kuarci 0,3-0,8 mm: 1,155 kg
- Sikagard®-680 S Betoncolor: 2750 kg
- Sika® MonoTop-412: 110 kg
- Sika® MonoTop-910 N: 110 kg

#### PJESËMARRËSIT NË PROJEKT

**Kontraktori kryesor:** GRANIT SHPK, Istog

**Nënkontraktor/ Aplikues:** A&F Construction SHPK, Prishtinë,  
Limiti L&B, Prizren

**Distributor:** Limiti L&B, Prizren

#### Sika Albania SHPK

Rinas Road, Tirana Business Park,  
Building no.7, 4-th floor  
Tirana, Albania

#### Contact

Phone: +355 4 454 0070  
Email: info@al.sika.com  
Website: alb.sika.com

**BUILDING TRUST**

